

L I G J
Nr. 8093, datë 21.3.1996

PËR REZERVAT UJORE

(Ndryshuar me ligjin nr. 8375, datë 15.7.1998; nr. 8605, datë 20.4.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuse”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të sigurojë ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të rezervave ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin socialekonomik të vendit;
- b) të sigurojë shpërndarjen drejt të rezervave ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre;
- c) të sigurojë mbrojtjen e rezervave ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe harxhimet mbi nevojat faktike;
- ç) të përcaktojë kuadrin institucional në nivel kombëtar e në nivel basenesh, për vënien në jetë të një politike kombëtare lidhur me drejtimin dhe administrimin e burimeve ujore në të mirë të popullsisë dhe interesave sociale e ekonomike të vendit.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

- 1. “Rezervat ujore” janë të gjitha ujërat e brendshme detare, sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë.
- 2. “Shtrati natyror i rrjedhës së përhershme a të përkohshme” është pjesa e tokës që mbulohet nga uji deri në nivelin maksimal të moskapërderdhjes anash.
- 3. “Shtrati i rrjedhës”, përgjatë të cilit rrjedhin zakonisht ujërat e reshjeve, është sipërfaqja mesatare ujore gjatë një sezoni reshjesh mesatare vjetore 25-vjeçare.
- 4. “Shtrati i liqeneve, pellgjeve dhe rezervave sipërfaqësore” është sipërfaqja e tokës e mbuluar me ujë, kur arrihet niveli maksimal 25-vjeçar.
- 5. “Brigjet” janë rripa anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve, që në funksion të përdorimit përfshijnë si minimum dy zona:
 - a) me gjerësi 5 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrët dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal 25-vjeçar të ujit në brigjet e sheshta, që

përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

b) me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal 25-vjeçar të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga autoritetet e ujit.

Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10 për qind në drejtim normal me bregun.

Gjerësia e të dy zonave, e përcaktuar më lart, mund të rritet me dispozita të veçanta vetëm kur kushtet topografike a të rezervave ujore të shtrateve ose brigjeve të lumenjve e bëjnë këtë të nevojshme për sigurinë e jetës dhe pronës.

6. “Basen ujëmbledhës” është sipërfaqja e tokës brenda së cilës uji, pasi konvergon në një rrjedhë të vetme nëpërmjet një rrjeti rrjedhash sipërfaqësore e nëntokësore, derdhet në det. Kufijtë gjeografikë të basenit ujëmbledhës përcaktohen nga hartat topografike sipas vijave ujëndarëse.

7. “Përdorues” quhet çdo rreth, bashki, fshat, komunë, shoqatë e përdoruesve të ujit, ndërmarrje shtetërore a private, person fizik dhe juridik që merret me eksplorimin, prodhimin, përdorimin e rezervave ujore dhe shkarkon ujëra të tepërta, të përdorura ose substanca të tjera.

8. “Shkarkim” do të thotë çdo derdhje a depozitim, drejtëpërsëdrejti a tërthorazi, i ujërave të tepërta, të përdorura, të zeza, mbeturinave, produkteve e nënprodukteve kimike, industriale a substancave të tjera, pavarësisht nga natyra e tyre, në rezervat ujore në tokë, nëntokë apo vende të gërmuara.

9. “Ndotja e ujit” është veprimi dhe ndikimi i futjes së materialeve të ngurta, të gazëta, të lëngëta, qenieve të gjalla dhe formave të energjisë në ujë, që drejtpërdrejt a tërthorazi ndryshojnë cilësinë e ujit, duke rrezikuar kështu përdorimin e tij të mëtejshëm.

10. “Leje” është një e drejtë e dhënë me shkrim nga organet e përcaktuara në këtë ligj për të përdorur një sasi uji ose shkarkim për një qëllim dhe një kohë të caktuar. Anulimi i lejes bëhet sipas nenit 23.

11. “Autorizim” do të thotë leje me shkrim nga organet e përcaktuara në këtë ligj që lejon mbajtësin e tij të kryejë kërkime, studime, eksplorime ose veprimtari të tjera të këtij lloji, ku përdorimi a shkarkimi i ujit nuk është qëllimi i dhënies së autorizimit.

12. “Licencë” është një e drejtë me shkrim që merret nga organet kompetente të përcaktuara sipas dispozitave ligjore, që e lejon mbajtësin e saj të kryejë veprimtari profesionale në fushat e zbatimit të këtij ligji.

13. “Koncesion” është një formë kontrate me shkrim, me të cilën organet e përcaktuara në këtë ligj i lejojnë mbajtësit të tij të gëzojnë një të drejtë ekskluzive për përdorimin e rezervave ujore, ose të kryejë shkarkime siç specifikohet në kushtet e koncesionit. Përdorimi i rezervave ujore dhe shkarkimi prezupozojnë që mbajtësi i koncesionit të jetë i pajisur me licencat përkatëse për veprimtaritë e përcaktuara në koncesion.

14. “Strategjia kombëtare e ujërave” është:

(i) përcaktimi i objektivave kombëtare në fushën e rezervave ujore, i strukturave institucionale për zbatimin e strategjisë, duke përfshirë kuadrin ligjor, rregullator e teknik dhe caktimin e mekanizmave bashkërendues;

(ii) plotësimin e kërkesave për ujë të balancuara e bashkërenduara me zhvillimin kombëtar, rajonal e sektorial, duke marrë parasysh mundësinë e shfrytëzimit të rezervave ujore;

(iii) identifikimi i programeve dhe projekteve parësore për zbatimin e strategjisë afatshkurtër, afatmesëm e afatgjatë;

(iiii) ruajtja dhe racionalizimi i përdorimit të ujit në harmoni me mjedisin dhe rezervat e tjera natyrore;

15. “Autoriteti i ujit” është:

(i) Këshilli i basenit, autoriteti i të cilit ushtrohet brenda kufijve të një baseni;

(ii) Këshilli Kombëtar i Ujit dhe sekretariati teknik i tij, autoriteti i të cilëve ushtrohet

në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

16. “Përdorimi i lirë i ujit” quhet ai që mund të kryhet pa ndonjë formalitet paraprak administrativ.

17. “Efektet e dëmshme të ujit” janë dëmtimet e shkaktuara nga përmytjet dhe plotat e jashtëzakonshme, kripëzimet e tepërta, gërryerjet, erozioni i tokës, mbushjet materiale të ngurta etj.

Neni 3

Pronësia shtetërore

1. Janë pronë shtetërore:

a) Të gjitha rezervat ujore të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1, të këtij ligji.

b) Gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve a rrjedhjeve të tjera ujore, të përherëshme a të përkohshme, kanaleve, liqeneve, hauzeve, lagunave dhe rezervuareve, natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretër të lumenjve, liqeneve dhe rezervuareve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësorë.

c) Të gjitha objektet dhe veprat hidroteknike të kryera nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit, lundrimit, ujësjellësit dhe kanalizimet e veprat përkatëse të tyre.

ç) Toka e krijuar nga tërheqja e ujit ose përparimi i tokës në dëm të ujit është pronë shtetërore.

2. E drejta e pronësisë së shtetit, për sa flitet në pikën 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

KREU II

ADMINISTRIMI I REZERVAVE UJORE

Neni 4

Parimet e administrimit

1. Administrimi publik i ujit bazohet në parimet e mëposhtme:

a) Në respektimin e integritetit të basenit ujëmbajtës, duke mbajtur parasysh kërkesat socialekonomike për rezervat ujore dhe duke mbrojtur e ruajtur cilësinë e këtyre rezervave për brezat e ardhshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

b) Në integrimin e kontrollit publik mbi rezervat ujore me planifikimin territorial dhe me projektet e zhvillimit social-ekonomik në nivel kombëtar, rajonal e lokal.

c) Në përdorimin racional të rezervave ujore dhe në shkarkimin e kontrolluar.

Neni 5

Organet e administrimit të ujit

1. Administrimi i burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë kryhet nga Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) dhe nga sekretariati teknik në nivel kombëtar, si dhe nga autoritetet e baseneve në nivel lokal e nga agjenci a organizma të tjerë që mund të caktojë KKU.

2. Këshilli i Ministrave përcakton përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit, duke përfaqësuar në të organet dhe institucionet qendrore që kanë si veprimtari kryesore ujin.

3. Këshilli Kombëtar i Ujit përcakton përbërjen e sekretariatit teknik të ujit dhe të këshillave të baseneve.

4. Për administrimin e ujërave kufitare, me propozimin e KKU, Këshilli i Ministrave emëron një komision të posaçëm që administron marrëdhëniet për këto ujëra me shtetet kufitare,

duke u bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në konventat përkatës ndërkombëtare.

Neni 6

Këshilli Kombëtar i Ujit dhe detyrat e tij

Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) është organi qendror vendimor për administrimin e rezervave ujore. Këshilli Kombëtar i Ujit drejtohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Këshilli Kombëtar i Ujit ka për detyrë:

a) Të propozojë projektligje dhe akte nënligjore për çdo lloj veprimtarie në fushën e rezervave ujore.

b) Të përgatitë kuadrin ligjor, teknik e rregullator për zbatimin e këtij ligji, si dhe të nxjerrë udhëzime e të ndërmarrë veprime të tjera të nevojshme për zbatimin e planit kombëtar të rezervave ujore.

c) Të drejtojë dhe miratojë planet e baseneve ujëmbledhëse.

ç) Të japë miratimin për planet dhe projektet ndërrajonale e kombëtare në fushën e bujqësisë, urbanistikës, zhvillimit industrial e territorial, në atë masë që këto plane dhe projekte kanë lidhje me planifikimin, administrimin e ruajtjen e rezervave ujore.

d) Të përcaktojë kufijtë territorialë të zonave përkatëse të baseneve ujëmbledhëse në gjithë vendin dhe të përcaktojë vendodhjen ku do të jetë qendra e basenit dhe ku do të mbahet regjistri i ujërave.

dh) Të krijojë organe a njësi organizative të varura nga Këshilli për të lehtësuar administrimin e rezervave ujore dhe për zbatimin e këtij ligji.

e) Të propozojë e adaptojë masa të përshtatshme për zbatimin e çdo marrëveshjeje ndërkombëtare e konvente për resurset ujore, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë nënshkruese.

ë) Të miratojë dhënien e koncensioneve për rezervat ujore në rastet e parashikuara nga dispozita e Këshillit të Ministrave. Kur këto rezerva kanë rëndësi kombëtare, marrëveshja hyn në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi Popullor.

2. Këshilli Kombëtar i Ujit mund të kryejë edhe funksione të tjera që i ngarkohen me akte të veçanta të Këshillit të Ministrave.

3. KKU ka të drejtë të kërkojë nga ministritë, komitetet, agjencitë dhe gjithë njësitë e tjera shtetërore informacione, të dhëna, analiza ose mbështetje tekniko-konsultative të nevojshme që KKU të përgatitë strategjinë kombëtare të ujit dhe planin kombëtar të rezervave ujore.

Neni 7

Sekretariati teknik

Sekretariati teknik është organ ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit, i cili krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe ka për detyrë:

a) Të zbatojë politikën kombëtare të rezervave ujore të miratuara nga KKU.

b) Të zbatojë dispozitat e këtij ligji.

c) Të përpilojë inventarin qendror të rezervave ujore si në aspektin e tyre sasior, ashtu edhe atë cilësor, sipas rregullave që vendos KKU.

ç) Të japë leje dhe autorizime për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm.

d) Të nxitë pjesëmarrësit e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e rezervave ujore.

dh) Të zbatojë dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare për rezervat ujore transkufitare, palë e të cilave është edhe Republika e Shqipërisë.

e) Të nxjerrë raporte dhe të japë opinione për çështjet që kanë të bëjnë me rezervat ujore dhe t'ia parashtrojë KKKU për miratim. Dikasteret, institucionet kërkimore-shkencore dhe organet e tjera shtetërore detyrohen t'i përgjigjen në kohën e duhur këkesave të sekretariatit teknik për informacion, asistencën ose për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për përgatitjen e studimeve.

ë) Të nxitë studime e kërkime për zhvillimin e novacioneve teknike që lidhen me përdorimin, zbulimin, shfrytëzimin, ruajtjen, riciklimin, trajtimin, mbrojtjen, administrimin dhe përdorimin efikas të rezervave ujore.

f) Në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore, të përcaktojë fushat e kërkimit dhe studimit për rezervat ujore, si dhe fondet përkatëse për to.

Neni 8

Këshillat e baseneve ujëmbledhës

1. Këshillat e baseneve ujëmbledhës (KBU) janë autoritete lokale përgjegjëse për administrimin e rezervave ujore në basenet përkatëse.

2. Në çdo basen lumi ose grup-basenesesh lumenjsh të Republikës së Shqipërisë krijohet këshilli i basenit, me të vetmet kufizime që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Këshilli i basenit ka status juridik dhe varet nga sekretariati teknik i KKKU.

3. Përbërja, të drejtat dhe detyrat e këshillave të baseneve caktohen nga KKKU.

KREU III

STRATEGJIA KOMBËTARE E UJIT DHE PLANIFIKIMI I REZERVAVE UJORE

Neni 9

Strategjia kombëtare e ujit

Strategjia kombëtare e ujit hartohet nga institucione të specializuara, nën drejtimin e sekretariatit teknik, dhe miratohet nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

Neni 10

Planifikimi i rezervave ujore

1. Plani kombëtar i rezervave ujore dhe plani i rezervave ujore të baseneve ujëmbledhës është detajimi i vendimeve të adoptuara nga Këshilli Kombëtar i Ujit për zbatimin e strategjisë kombëtare të ujit. Shtrirja territoriale dhe dispozitat për zbatimin e këtyre planeve do të përcaktohen në aktet e nxjerra nga KKKU.

2. Planet e lartpërmendura janë publike dhe të detyrueshme. Ato bashkërendohen me planet e tjera, të cilat mund të ndikohen reciprokisht. Procedurat e përpunimit, rishikimit dhe miratimit të planeve të rezervave ujore përcaktohen me rregullore.

KREU IV

E DREJTA PËR TË PËRDORUR UJIN

Neni 11

Qëllimet e përdorimit të ujit

Uji do të përdoret për këto qëllime:

Shtëpiake, komunale, bujqësore (duke përfshirë ujitjen dhe ujin për blegtorinë), akuakulturë, peshkim, transport ujor, industriale, prodhim, hidroenergji, tregtare, turizëm,

argëtim (duke përfshirë lundrimin për zbavitje) dhe për qëllime të tjera, që miratohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

Neni 12

Kushtet dhe regjimet e përdorimit të ujit

Askush nuk ka të drejtë ta përdorë ujin pa leje, autorizim ose koncesion të lëshuar nga autoritetet e ujit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 13.

Përdorimi i rezervave natyrore të ujit i nënshtrohet kontrollit administrativ të autoriteteve të ujit. Autoritetet e ujit respektojnë 4 regjimet e mëposhtme që rregullojnë administrimin e rezervave ujore:

- a) përdorimi i lirë i ujit;
- b) përdorimi i ujit me leje;
- c) përdorimi i ujit me autorizim;
- ç) përdorimi i ujit mbi bazë koncesioni.

Neni 13

Përdorimi i lirë i ujit

1. Çdokush ka të drejtë t'i përdorë burimet sipërfaqësore ujore lirisht për të pirë, për nevoja të tjera shtëpiake, të blegtorisë, pa tejkaluar nevojat, sasitë e nevojshme për plotësimin e nevojave individuale dhe familjare të përdoruesit dhe në përputhje me ligjet përkatëse dhe planet e këshillave të baseneve.

2. Çdokush ka të drejtë të përdorë lirisht ujërat e brigjeve për të bërë banjë, si dhe ushtrimin e sporteve ujore.

3. Çdokush ka të drejtë të përdorë lirisht ujërat e shirave që bien në tokë në pronësi private, me kusht që ky ujë të mos të grumbullohet me instalime artificiale.

4. Autoritetet e ujit mund të kufizojnë përdorimin e lirë të ujit në gjithë vendin ose në zona të veçanta në periudhat e mungesës së ujit, të dëmtimeve të cilësisë së tij ose të përhapjes së sëmundjeve që shkaktohen nga uji.

Neni 14

Përdorimi me leje i ujit

1. Veprimtaritë e mëposhtme do të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mbi bazën e një leje administrative të lëshuar nga autoritetet e ujit.

- a) Përdorimi i ujit, kur ky realizohet me instalime të përhershme.
- b) Ujitja.
- c) Blegtoria.
- ç) Akuakultura.
- d) Përdorime industriale të ujit, duke përfshirë minierat.
- dh) Shfrytëzimi i ujërave nëntokësorë për qëllime të ndryshme, duke përfshirë edhe ato shtëpiake.
- e) Mbjellja e pemëve ose e bimëve në brigjet e lumenjve e përrenjve, kur ato përbëjnë një pengesë për rrjedhjen natyrore të ujit.
- ë) Nxjerrja e inerteve nga shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve dhe rezervuareve, qofshin me ose pa ujë.

2. Përdorimet e mëposhtme kërkojnë leje përkatëse të Këshillit Kombëtar të Ujit.

- a) Lundrueshmëria.
- b) Ndërtimi i strukturave ankoruese dhe portuale.

3. Autoritetet e ujit përcaktojnë rezervat ujore ku ndalohet veprimtaria e peshkimit.

Mbrojtja, përdorimi dhe shfrytëzimi i zonave të peshkimit, si dhe programet që kanë të bëjnë me ripërtëritjen e resurseve të peshkimit, realizohen në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse dhe me ato të mbrojtjes e ruajtjes së mjedisit.

4. Çdo veprimtari që nuk përfshihet në këtë nen, nuk përjashton përdorimin e rezervave ujore pa një leje në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 15

Përdorimi me autorizim i ujit

(Shtuar fjali me ligjin nr. 8375, datë 15.7.1998)

Të gjitha llojet e kërkimeve, studimeve dhe eksplorimeve në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, edhe kur nuk kanë për objekt ujin, kryhen me autorizim nga autoritetet përkatëse të ujit për një zonë dhe kohë të caktuar. Përjashtohet nga kjo kërkesë Shërbimi Hidrometeorologjik Publik.

Neni 16

Përdorimi me koncesion i ujit

1. Përdorimi i rezervave ujore sipërfaqësore a nëntokësore për qëllime publike, ose brenda kuadrit të shërbimeve publike, si prodhimi, furnizimi me ujë të pijshëm, prodhimi i hidroenergjisë, ujitja e tokës nga ndërmarrje bujqësore ose një shoqatë e përdoruesit të ujit, nxjerrja e gazeve dhe hidrokarbureve me anë të shfrytëzimit të ujërave nëntokësore dhe instalimeve të tjera të përhershme, si dhe konfeksionimi i ujit, do të kryhen mbi baza koncesioni.

2. Kur një mbajtës i një autorizimi ka kryer një studim të suksesshëm dhe kushtet e autorizimit e parashikojnë këtë, pala e autorizuar ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për leje ose koncesion brenda një periudhe 6-mujore nga data e përfundimit të studimit. Pas kalimit të këtij afati autoritetet e ujit kanë të drejtë të ndjekin zbatimin dhe procedurat normale sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 17

Detyrat e përdoruesve të ujit

Përdoruesit e ujit duhet të:

- a) Përdorin ujin në mënyrë racionale dhe ekonomike.
- b) Të respektojnë kushtet dhe detyrimet e përcaktuara mbi të drejtën e pronësisë.
- c) Të sigurojnë mbrojtjen e ujit nga ndotja dhe të mbajnë nën kontroll cilësinë e ujit, si dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet e ndryshme.
- ç) Të respektojnë të drejtat e përdoruesve të tjerë të ligjshëm të ujit dhe të të tretëve.

KREU V

LEJET, AUTORIZIMET DHE KONCESIONET PËR PËRDORIMIN E UJIT

Neni 18

Dispozita të përbashkëta për lejet, autorizimet dhe koncesionet për përdorimin e ujit

Lejet, autorizimet dhe koncesionet për përdorimin e ujit do të jepen nga autoritetet përkatëse të ujit, në bazë të parimit të konkurrencës së lirë dhe sipas procedurave të parashikuara në aktet e nxjerra nga Këshilli i Ministrave për zbatimin e këtij ligji. Leja ose autorizimi lëshohen nga këshilli i basenit, kur veprimtaria për të cilën lëshohen parashikohet të kryhet

brenda kufijve të një baseni, dhe territorit të Republikës së Shqipërisë nga KKU, kur kjo veprimtari do të kryhet në një zonë jashtë kufirit të një baseni të vetëm, por brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Koncesionet jepen nga KKU ose nga këshillat e baseneve, në bazë të klasifikimit të burimeve ujore që nxjerr Këshilli i Ministrave me akte nënligjore.

Lejet, autorizimet dhe koncesionet për përdorimin e ujit:

a) janë personale dhe nuk mund të transferohen pa miratimin e autoriteteve përkatëse të ujit;

b) janë të përkohshme dhe nuk mund të rinovohen në çdo kohë pa cenuar interesin publik;

c) mund të modifikohen, kufizohen ose anulohen, kur nuk janë në përputhje me kushtet e lëshimit të tyre, me kërkesën e mbajtësit të tyre ose në rastet e konstatimit të shkeljeve të ndryshme;

ç) i nënshtrohen pagesave për shpenzimet administrative dhe do të përfshihen në regjistrin e lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve për përdorim uji;

d) lejet, autorizimet dhe koncesionet nuk mund të refuzohen pa një vendim të motivuar;

dh) lejet, autorizimet dhe koncesionet lëshohen me afate si vijon:

- Leje për përdorues - deri në 5 vjet.

- Leje për përdorues një shoqatë përdoruesish të ujit - deri në 10 vjet.

- Leje për hapje pusesh - deri në një vit.

- Autorizimet për kërkime, studime dhe eksplorime - deri në 2 vjet.

- Koncesionet - kohëzgjatja fillestare jo më tepër se 30 vjet.

Neni 19

Shtyrja e afatit të koncesioneve

Nëse gjatë periudhës së specifikuar në koncesion bëhet absolutisht e nevojshme të kryhen disa punime shtesë të caktuara, kostoja e të cilave nuk mund të amortizohet brenda kohës së mbetur deri në përfundim të koncesionit, ai mund të shtyhet nga autoritetet e ujit për një periudhë tjetër të nevojshme për të lejuar autorizimin deri në një kufi prej 10 vjetësh.

Me qëllim që të kualifikohesh për shtyrje afati, punime të cilat duhet të amortizohen, duhet të kenë qenë ndërtuar në përputhje me planin e rezervave ujore në fuqi. Mbajtësi i koncesionit duhet të provojë dëmet që ai do të pësonte, në qoftë se nuk do t'i shtyhej afati.

Neni 20

Lejet dhe autorizimet për shfrytëzimin e materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve, përrenjve etj

Lejet dhe autorizimet për shfrytëzimin e materialeve inerte (rërë, zhavorr etj.), që nxirren nga shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve, liqeneve etj., qofshin me ose pa ujë, jepen nga autoritetet e ujit.

Neni 21

Përparësitë në dhënien e lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve

1. Për dhënien e një leje, autorizimi a koncesioni, autoritetet përkatëse të ujit do të mbështeten në përparësitë e mëposhtme:

a) Furnizimi me ujë i popullsisë (duke përfshirë edhe kërkesat e industrive që ndodhen brenda vijës kufizuese të qendrave të banuara dhe që kanë një nivel të ulët konsumi).

b) Përdorime për ujitje, bujqësi e akuakulturë.

- c) Përdorime për prodhim hidroenergjie.
- ç) Përdorime të tjera industriale, që nuk përfshihen në kategorinë e mësipërme, duke përfshirë edhe përdorime në miniera.
- d) Peshkim.
- dh) Transport ujor.
- e) Argëtim e turizëm, duke përfshirë lundrimin për zbavitje.
- ë) Përdorime të tjera.

Neni 22

Ndryshimi i kushteve të lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve

Çdo ndryshim në kushtet e parashikuara në një leje, autorizim dhe koncesion do të bëhet me miratim të organit që e ka lëshuar atë.

Lejet, autorizimet dhe koncesionet mund të rishikohen kur:

- a) kushtet e dhënies kanë ndryshuar;
- b) në rastet e ndryshimeve për shkak të forcave madhore;
- c) duhet azhurnuar me planet e rezervave ujore.

Neni 23

Anulimi i lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve

1. Lejet, autorizimet dhe koncesionet mund të anulohen, pezullohen ose kufizohen, në rast se nuk plotësohet ndonjë nga kushtet ose afatet e përcaktuara në to.

2. Lejet, autorizimet dhe koncesionet mund të anulohen, pezullohen ose kufizohen nga autoritetet e ujit, kur burimet ujore janë drejt shërrimit.

Neni 24

Licencat për shpuesit për ujë nëntokësor

1. Shpuesi profesionist për ujë, që e ushtron veprimtarinë e tij mbi bazë tregtare, duhet të jetë i pajisur me licencë shpimi për ujë. Procedurat për kërkimin dhe dhënien e saj do të përcaktohen me anë të rregulloreve të nxjerra nga K KU. Licenca e shpuesit i nënshtrohet pagesës për shpenzimet administrative.

2. Për çdo shpim duhet të merret një leje shpimi pranë autoriteteve të ujit, ose nga shpuesi profesionist, apo nga personi për të cilin ai ndërmerr operacionin e shpimit.

3. Shpuesi profesionist, në përfundim të shpimit, duhet t'u paraqesë autoriteteve të ujit një raport të detajuar hidrogeologjik në lidhje me shpimin, me mostrat e shtresave të shpuara, si dhe me gjithë dokumentacionin përkatës që kërkohet sipas rregulloreve të hartuara nga K KU. Këto të dhëna duhet të paraqiten pranë autoritetit të ujit, që ka dhënë lejen për shpim jo më vonë se dy muaj pas përfundimit të shpimit.

4. Nuk lejohet marrje uji nga pusi mbi sasinë e shënuar në lejen e shpimit ose përdorimi i tij për qëllime të tjera nga ai për pirje, larje, pirje për bagëti personale (që nuk shërbejnë për qëllime tregtare) dhe qëllime të tjera shtëpiake. Në rast përdorimi për qëllime të tjera, aplikanti duhet të kërkojë koncesion.

Neni 25

Ujërat kurative, minerale dhe termale

Përdorimi i ujërave kurative, minerale dhe termale disiplinohet me ligje të veçanta.

KREU VI

MBAJTJA NËN KONTROLL DHE MBROJTJA E CILËSISË SË REZERVAVE UJORE

Neni 26

Cilësia e ujit të pijshëm

1. Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, përcakton standartet shtetërore të cilësisë së ujit që destinohet për konsum njerëzor. Çdo person fizik a juridik, publik apo privat, që ofron ose shet në publik ujë të pijshëm a për përpunimin e ushqimeve, detyrohet të garantojë kërkesat e përcaktuara për standartet shtetërore që destinohen për konsum njerëzor.

2. Komunitet, bashkitë dhe ndonjë institucion tjetër publik a privat, që kanë sistemin e vet të furnizimit me ujë, janë të detyruara të marrin masa për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit të shpërndarë. Autoritetet e ujit mund të urdhërojnë ndërprerjen e shpërndarjes së ujit, i cili nuk i përmbahet standarteve të cilësisë.

3. Asnjë person fizik a juridik nuk ka të drejtë të ndërhyjë në sistemin e furnizimit me ujë publik, me përjashtim të zotëruesve të lejes ose koncesionit të dhënë për këtë sistem.

KREU VII

SHKARKIMET DHE KANALIZIMET

Neni 27

Shkarkimi i lëndëve me ujë

1. Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë a në gropa, bëhen me leje, autorizim ose koncesion të lëshuar nga autoriteti i basenit.

2. Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit bashkëpunojnë për përcaktimin e standarteve dhe kërkesave për llojet e ndryshme të veprimtarive të shkarkimit.

Neni 28

Kanalizimet e ujërave të zeza

1. Rrjeti i ujërave të zeza do të planifikohet i tillë që të largojë me shpejtësi e të derdhë në vendet e caktuara, larg vendbanimeve njerëzore, ujërat e zeza që vijnë nga banesat.

2. Ndërtimi i rrjetit të ujërave të zeza do të jetë i tillë që të shmangë mundësinë që derdhjet, të cilat ai i largon për në destinacionin e tyre përfundimtar, të jenë arsyeja e infektimit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, si dhe ujit të detit. Ndërtimi i tyre do të jetë objekt i një koncesioni të dhënë nga autoritetet e ujit dhe gjithmonë në përputhje me dispozitat ligjore.

3. Autoritetet e ujit mund të imponojnë vendosjen e instalimeve sanitare për ndërtesat ekzistuese, sa herë që e kërkojnë kushtet higjienike.

4. Kushdo mund të marrë përgjegjësinë e grumbullimit, transportimit, përpunimit dhe derdhjes në vendet e caktuara të ujërave të zeza. Ndërtimi i objekteve dhe instalimeve të nevojshme për një gjë të tillë është objekt i koncesionit të lëshuar nga autoritetet e ujit.

5. Askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza, përveç koncesionarit që drejton këtë veprimtari.

Neni 29

Sistemi individual dhe kolektiv i shkarkimit

Kur disa persona përdorin një sistem kolektiv shkarkimi ose kanalizimi, përgjegjës përpara autoriteteve të ujit është enti që shfrytëzon sistemin e shkarkimit ose të kanalizimit.

Në rastin e një shkarkuesi të vetëm, shkarkuesi është individualisht përgjegjës përpara autoriteteve të ujit, qoftë ky familjar ose jofamiljar.

Neni 30

Kontrolli i impianteve të pastrimit

Autoritetet e ujit kanë të drejtë të marrin përgjegjësinë e drejtpërdrejtë a të tërthortë për shfrytëzimin e impianteve të pastrimit të ujërave të zeza në ato raste kur mbajtësi i lejes, autorizimit ose koncesionit, është i paaftë ose nuk dëshiron të përmbushë kushtet e lejes, autorizimit ose koncesionit. Mbajtësi i lejes është i detyruar t'i paguajë autoriteteve të ujit të gjitha detyrimet që rezultojnë nga punimet:

a) për të korrigjuar ose modifikuar impiantin, siç specifikohet në leje, autorizim ose koncesion;

b) shpenzimet e papaguara që rezultojnë nga shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e impiantit.

KREU VIII

LEJET, AUTORIZIMET DHE KONCESIONET PËR SHKARKIME

Neni 31

Dispozita të përbashkëta për leje, autorizime dhe koncesione

1. Kërkesa për leje, autorizimet dhe koncesionet e shkarkimit duhet të përmbajnë në detaje kriteret që do të plotësohen nga shkarkuesi, siç parashikohet në rregulloret në fuqi. Ato do të përfshijnë një përshkrim të impiantit të pastrimit, pajisjet dhe procedurat vëzhguese për të siguruar funksionimin e tij korrekt, si dhe çdo kufizim të vënë për përmbajtjen kimike e bakteriologjike të shkarkimit.

2. Karakteristikat e lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve të shkarkimit do të jenë të njëjta me ato të përdorimit të ujit. Në çdo rast ato të përmbajnë kushtet lidhur me impiantet e përpunimit, vëzhgimit e sinjalizimit, si dhe do të vendosin mbi standartet e afluentëve.

3. Lejet, autorizimet dhe koncesionet e shkarkimit do t'i nënshtrohen pagesës për shpenzimet administrative dhe do të hyjnë në regjistrin e lejeve, autorizimeve e koncesioneve për shkarkime.

4. Lejet, autorizimet dhe koncesionet për shkarkim lëshohen pasi merret miratimi edhe nga dikasteret e specializuara, të ngarkuara për këtë punë nga Këshilli i Ministrave.

5. Lejet, autorizimet dhe koncesionet për veprimtaritë e shkarkimit që mund të shkaktojnë infiltrimin ose akumulimin në kohë të substancave në ujërat sipërfaqësore, shtretërit natyrorë ose artificialë, shtresat ujëmbajtëse ose ujërat nëntokësore, do të jepen vetëm pas një studimi kompleks të bërë brenda një viti nga data e kërkesës për leje shkarkimi. Studimi do të kryhet nga institucione të kualifikuara, të ngarkuara nga Këshilli i Ministrave dhe, pasi ky studim të ketë konfirmuar se nuk do të ndodhë asnjë degradim në cilësinë e rezervave ujore, autoriteti i ujit jep lejen, autorizimin ose koncesionin për këtë veprimtari.

6. Ripërdorimi i ujërave të përdorura është objekt i lejeve administrative. Në rast se ripërdorimi i ujërave do të bëhet prej një subjekti të ndryshëm nga përdoruesi i parë, atëherë të dy përdoruesit duhet të pajisen me leje të veçanta. Këshilli Kombëtar i Ujit do të përcaktojë rregullat për ripërdorimin e drejtpërdrejtë të ujërave të përdorura, duke u bazuar në proceset e pastrimit, cilësisë dhe qëllimin e përdorimit të këtyre ujërave.

Neni 32
Lejet administrative

Lejet administrative për ndërtimin, ndryshimin ose transferimin e ndërmarrjeve ose industrive që bëjnë ose mund të bëjnë shkarkime ujërash të përdorura dhe të zeza, do të jepen vetëm me kushtin që të jetë marrë më parë licenca, leja, autorizimi a koncesioni për shkarkimin.

Neni 33
Refuzimi i lejeve, autorizimeve ose koncesioneve

Autoritetet e ujit kanë të drejtë t'i refuzojnë lejet, autorizimet dhe koncesionet për veprimtari ose procese industriale, derdhjet e të cilave, pavarësisht nga trajtimi ose përpunimi, paraqesin një rrezik serioz për ndotjen e rezervave ujore, sistemin ekologjik dhe mjedisin.

Neni 34
Ndryshimi i lejeve

Këshilli i basenit ujëmbledhës do t'i bëjë një rekomandim organit epror në lidhje me pezullimin e përkohshëm ose të përhershëm ose ndryshimin e lejes, autorizimit a koncesionit, kur është në kompetencën e këtij organi, nëse rrethanat në të cilat është bazuar dhënia e tyre kanë ndryshuar, ose krijohen rrethana të reja, të cilat, nëse do të kishin ekzistuar në kohën e dhënies, do të kishin çuar në refuzim të lejes ose lëshimin e lejes me kushte dhe afate të tjera.

Neni 35
Ndërprerja e veprimtarive

Autoritetet e ujit kanë të drejtë të urdhërojnë për ndërprerjen e menjëhershme të të gjitha veprimtarive, nga të cilat rezultojnë shkarkime të paautorizuara që dëmtojnë interesin publik.

Neni 36
Pagesat për shpenzimet administrative

Aktivitetet e autorizuara të shkarkimit do t'i nënshtrohen pagesave dhe shpenzimeve administrative sipas kriterëve dhe tarifave të vendosura nga Këshilli i Ministrave.

KREU IX
EFEKTET E DËMSHME TË UJIT

Neni 37
Dispozita të përgjithshme

Këshilli Kombëtar i Ujit, në bashkëpunim me organet përkatëse, harton projektet dhe programet, duke përfshirë planet e ujitjes dhe praktikat e kultivimit të bimëve, kullimin, mbrojtjen e brigjeve të lumenjve dhe ripyllëzimet për mënjanimin e efekteve të dëmshme të ujit.

Neni 38
Plotat

1. Autoritetet e ujit imponojnë, brenda sipërfaqeve që i nënshtrohen vërshimeve, gjithë masat e nevojshme për të siguruar njerëzit dhe pronat. Në rast plotash të mëdha, autoritetet e ujit mund të urdhërojnë ekzekutimin e punimeve të emergjencës, duke autorizuar dhe kërkuar zyrtarisht të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për këtë qëllim nga përdoruesit e ujit.

2. Çdo person fizik a juridik detyrohet të bashkëpunojë me këshillin e basenit në luftën kundër përmytjeve dhe efekteve të tjera të dëmshme të ujit, sipas përkufizimeve të nenit 2, paragrafi 17.

Neni 39 **Tokat e përmytura**

1. Tokat që mund të përmyten gjatë daljes nga shtrati i zakonshëm i liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lumenjve, përrenjve e rrjedhave të tjera, do të ruajnë statusin e tyre të mëparshëm ligjor. Në raste të veçanta KKU vendos kufizime për përdorimin e zonave të përmytura ose të zonave që janë nën efektet e dëmshme të ujit, kur këto rrezikojnë jetën e njerëzve e pronën e shtetasve.

2. Në zonat e kërcënuara nga përmytjet ndalohet magazinimi i materialeve e lëndëve që mund të shpëlahen në ujë. Ndalohet gjithashtu që në këto zona të ndërtohen objekte të reja.

KREU X **ZONAT DHE SIPËRFAQET E MBROJTURA**

Neni 40 **Zonat e mbrojtjes sanitare**

1. Me qëllim që të ruhet cilësia e ujit për qark burimit, caktohen zonat e mbrojtjes sanitare rrotull burimit sipërfaqësor ose nëntokësor të ujit, që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë urbane e rurale. Kufijtë e këtyre zonave do të përcaktohen sipas rregulloreve të hartuara nga sekretariati teknik i KKU me organet përkatëse të shëndetësisë.

2. Zonat e mbrojtjes do të përbëhen nga:

a) Një zonë e mbrojtjes imediate, e cila është e vendosur nën kontrollin e agjencisë që merret me nxjerrjen, prodhimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm. Kjo zonë rrethohet.

b) Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të ndërtohet ndërtesa, të ngrihet industri, të kryhet veprimtari bujqësore e blegtorale, të hapen puse, të gërmohen kanale, të depozitohen ose shkarkohen ndotjet, ujërat e zeza, substanca kimike e toksike, të përdoren plehurat kimike dhe pesticidet, të varrosen kufoma njerëzore e shtazore.

c) Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës veprimtaritë e parashikuara në shkronjën “b” do të jenë objekt leje administrative.

3. Personat fizikë dhe juridikë, interesat e të cilëve dëmtohen nga vendosja e zonave të mbrojtjes, kompensohen sipas ligjeve në fuqi.

Neni 41 **Zonat e mbrojtjes emergjente**

Zonat ose sipërfaqet e mbrojtura mund të përcaktohen dhe të krijohen nga autoritetet e ujit, kurdoherë që burimet sipërfaqësore ose nëntokësore janë seriozisht të kanosura në sasi e cilësi, kur konfliktet mes përdoruesve të ujit rriten, ose kur ekziston rreziku i përhapjes së sëmundjeve. Regjimi i këtyre zonave ose sipërfaqeve, si dhe kufizimet e tyre, do të vendosen mbi baza që ndryshojnë sipas rastit.

Neni 42
Rezervat e ujit

Me propozimin e këshillit të basenit dhe miratimin e KKU, zona të caktuara, basene, pjesë basenesh, rrjedha ujore, lumenj etj., mund të shpallen zona të një mbrojtjeje të veçantë, për shkak të tipareve të tyre natyrore a interesit ekologjik. Regjimi i administrimit dhe ruajtjes së tyre përcaktohet me akte nënligjore të veçanta.

Neni 43
Bashkërendimi i planeve të studimit urbanistik me ato të rezervave ujore

Planet dhe studimet urbanistike detyrohen të marrin në konsideratë planet e rezervave ujore të hartura nga KKU.

Neni 44
Tokat e mbuluara me ujë

Kënetat ose zonat që përmythen jashtë shtretërve sipas përkufizimeve të nenit 2, paragrafet 2, 3 dhe 4, duke përfshirë edhe ato të krijuara artificialisht, quhen toka të mbuluara me ujë. Përcaktimi i kufijve të tyre bëhet nga KKU. Të gjitha veprimtaritë që kryhen ose ndikojnë mbi to, i nënshtrohen lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve.

Neni 45
Zonat e rrezikshme për shëndetin

KKU, në bashkëpunim me organet përkatëse shëndetësore dhe të mbrojtjes së mjedisit, përcakton zonat e rrezikshme për jetën e shëndetin, të cilat deklarohen si të dëmshme për interesat publike, dhe vendos tharjen e tokave që janë nën ujë.

KREU XI
MBROJTJA E BRIGJEVE

Neni 46
Mbrojtja e përkohshme

Veprimtaritë mbrojtëse të përkohshme mund të kryhen nga persona juridikë, publikë dhe privatë në raste emergjence. Këto veprimtari kryhen me lejen e autoriteteve të ujit.

Neni 47
Mbrojtja e brigjeve

Mbrojtja e brigjeve me anë të ndërtimeve, rindërtimeve dhe mirëmbajtjes së pritave, veprave veshëse dhe veprave e masave të tjera teknike, ku përfshihen edhe ato biologjike, është detyrë publike.

Neni 48
Veprimtaritë ndërtimore në brigje

Objektet që i shërbejnë mbrojtjes së bregut, si dhe muret, shlusët e vepra të tjera në breg, si: ura, shkallë, gardhe, linja kabli ose tubash, ndërtesa mbi kolona, hendeqe ose rrugë, mund

të ndërtohen, ndryshohen a prishen vetëm me leje të autoriteteve të ujit.

Neni 49

Veprimtari të ndaluara në brigje dhe plazhe

1. Në brigje dhe plazhe është e ndaluar:

- a) të ndryshohet a zhvendoset mbulesa bimore ose artificiale;
- b) të merren materiale interne (rërë, zhavorr, gurë etj.) ose plisa;
- c) të ndërtohen vende parkimi për mjete ujore dhe automjete tokësore;
- ç) të krijohen vende të thata për rrjetat;
- d) të germohet, shpohet ose shkaktohen shpëlarje.

2. Autoritetet e ujit kanë të drejtë që me anë të dispozitave të rregullojnë, kufizojnë ose ndalojnë shfrytëzimin e plazhit, të fundit të detit, të dunave, të brigjeve të pjerrëta dhe të çdo sipërfaqeje tjetër që është përcaktuar për mbrojtjen e bregut dhe mirëmbajtjen e tij, kur këtë e kërkon siguri dhe mirëmbajtja e bregut.

KREU XII

VEPRAT DHE OBJEKTET UJORE

Neni 50

Ndërtimi

1. Ndërtimi i veprave dhe objekteve për shfytëzimin e rezervave ujore dhe për parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit janë objekt i lejeve administrative ose koncesioneve, kur këto janë brenda kuadrit të shërbimeve publike.

2. Brenda 15 ditëve nga përfundimi i veprës së objektit, personi fizik dhe juridik, autor i ndërtimit, duhet të njoftojë autoritetet e ujit që kanë lëshuar autorizimin ose koncesionin, që ky i fundit të kryejë inspektimin përfundimtar në këtë vepër a objekt ujqor.

Neni 51

Fuqitë e autoritetit të ujit

1. Autoriteti i ujit ka fuqi të imponojë instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e ujit në tokë private, si dhe të servituteve që nevojiten për hyrjen në instalime të tilla, për punën përgatitore dhe ndërtimin; të kontrollojë vënien në punë në afatet e përcaktuara në leje dhe mirëmbajtjen e objekteve të veprave hidroteknike, si dhe imponojë vendosjen e tubacioneve të transportit të ujit të pijshëm ose atij të kanalizimeve.

2. Autoriteti i ujit kryen kontrole periodike të objekteve dhe objekteve ujore. Për këtë personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të inspektojnë veprat dhe objektet dhe të kërkojnë të dhënat e dokumentacionin lidhur me to.

KREU XIII

SHOQATAT E PËRDORUESVE DHE SHKARKUESVE TË UJIT

Neni 52

Shoqatat e përdoruesve dhe shkarkuesve

Gjithë përdoruesit e ujit dhe personat e tjerë juridikë shtetërorë ose privatë që përdorin ujë nga një burim i vetëm që nga vetia e koncesionit ose shkarkojnë ujërat e zeza apo të

përdorura (industriale, bujqësore etj.), formojnë shoqata të përdoruesve dhe shkarkuesve të ujit.

Neni 53

Procedurat për krijimin dhe regjistrimin e shoqatave

Krijimi dhe regjistrimi i shoqatave të përdoruesve dhe shkarkuesve të ujit do të bëhet sipas dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore.

KREU XIV SERVITUTET

Neni 54 Servitutet

Pronarët ose qiramarrësit e tokave i zgjidhin problemet lidhur me servitutet sipas përcaktimeve të bëra në Kodin Civil.

Mosmarrëveshjet që lindin për servitutet, kur nuk zgjidhen ndërmjet palëve, kalojnë për kompetencë në gjykatë.

Neni 55 Veprimtari në brigje

Në tokat private dhe shtetërore përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet lënë detyrimisht:

a) Një sipërfaqe e lirë toke me gjerësi prej 5 deri 20 metrash nga këto brigje, sipas përkufizimit nr. 5/a të nenit 2 të këtij ligji, për përdorimin publik. Gjerësia e një sipërfaqeje të tillë mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve, ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjëve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë këtë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me dispozita të autoriteteve të ujit.

b) Një sipërfaqe toke me gjerësi 100 m deri 200 m, sipas përkufizimit nr. 5/b të nenit 2 të këtij ligji, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga autoriteti i ujit.

Neni 56 Të drejtat e pronarëve fqinjë të tokave

Pronari i tokës, në të cilën është caktuar servituti, mund të ofrohet për të marrë pjesë në ndërtimin e veprave ujore në një tokë të tillë. Në këtë rast ai do të përballojë:

- a) një pjesë të shpenzimeve të ndërtimit të veprës, nga e cila ai përfiton;
- b) shpenzimet për modifikimet që mund të bëhen të nevojshme nga ushtrimi i të drejtës së servitutit;
- c) një pjesë të shpenzimeve për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e veprave.

KREU XV DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 57 Pagesat e tarifave për përdorimin e ujit (çmimi i ujit)

1. Këshilli i Ministrave përcakton shumat që paguhet për përdorimin e ujit për qëllime të ndryshme. Në vendim Këshilli i Ministrave merr parasysh, por nuk kufizohet nga këta faktorë:

- a) lloji i ujit që kërkohet për përdorim;
 - b) qëllimi i përdorimit të ujit;
 - c) stina e vitit, gjatë së cilës përdoret uji;
 - ç) sasia e ujit të marrë;
 - d) nëse uji i përdorur është për konsum apo jo;
 - dh) linja mes shpenzimeve të planifikimit, ndërtimit, shfrytëzimit, mirëmbajtjes e amortizimit të objekteve ujore dhe të ardhurave të parashikuara për përdoruesin e ujit nga përdorimi i këtij objekti ujor;
 - e) përshtatshmëria e impianteve për trajtim dhe largimin e ujit pas përdorimit, në kuptimin e ndikimit mbi shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujit e mjedisin;
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e autoriteteve të ujit, mund të përjashtojë nga pagesat persona të caktuar fizikë a juridikë, shtetërorë ose privatë, kur ky përjashtim i shërben më mirë interesit publik.
3. Pagesat për tarifën e përdorimit të ujit mbledhen nga autoritetet e ujit.

Neni 58

Pagesat për shpenzimet administrative

Kushdo që kërkon leje, autorizim a koncesion për përdorimin apo shkarkimin e ujit, ose një leje a koncesion për ndërtimin e objekteve a veprave ujore sipas këtij ligji, do të paguajë për shpenzimet administrative. Këto pagesa mbledhen nga autoritetet e ujit.

Mjetet financiare që krijohen nga këto pagesa dhe nga tarifën për përdorimin e ujit përdoren vetëm për qëllime të fushës së shfrytëzimit të rezervave ujore në shkallë republike, si për punimet studimore, mbajtje statistikash, regjistrash uji, kadastrim, masa për mbrojtjen nga përmbytjet, zgjerimi dhe mirëmbajtja e rezervave ujore dhe investime të tjera të nevojshme në fushën e përdorimit të ujërave.

Neni 59

Stimujt financiarë

1. Qeveria mund t'u japë stimuj financiarë në formën e huave, përjashtimeve nga taksat dhe pagesat e tarifave për përdorimin e ujit, atyre që angazhohen në studime ose zhvillime të teknologjisë, proceseve, instalimeve dhe pajisjeve të reja, të cilat sjellin uljen e përdorimit ose konsumit të ujit, apo uljen e përqindjes së ndotësve në ujë. Stimujt financiarë mund t'u jepen edhe atyre që përkrahin e nxitin pyllëzimet dhe masa të tjera që shërbejnë për mbrojtjen e burimeve ujore.

2. Këto stimulime mund të shtrihen më gjerë tek ata që angazhohen në veprimtari shkripëzimi dhe trajtimi të ujërave të zeza, duke përdorur procese dhe metoda të përmirësuara, apo duke vendosur sistemet për ujin riqarkullues, ose angazhohen në veprimtari të kërkimeve në këtë fushë.

KREU XVI

SHKELJET DHE SANKSIONET

Neni 60

(Hequr referenca me ligjin nr. 8605, datë 20.4.2000)

Për shkelje të parashikuara në nenin 14 në pikat 1, paragrafët a, b, c, ç, d, dh, dhe e kundërvajtësi dënohet me gjobë deri 1 000 000 lekë.

Shkeljet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, paragrafi a dhe b, si dhe në nenin 26, pika 3, dënohen me gjobë deri në 2 000 000 lekë.

Neni 61

(Shtuar paragrafë me ligjin nr. 8605, datë 20.4.2000)

Për shkelje të parashikuara në nenin 15 kundërvajtësi dënohet me gjobë deri 1 000 000 lekë.

Për shkeljet e parashikuara në nenin 14 pika 1 shkronja “ë” dhe në nenet 20, 24 paragrafi 1 dhe 2, 47, 48, 49 dhe 50 të këtij ligji, kundërvajtësi dënohet nga Kryetari i Degës së Policisë së Ndërtimit në rreth në varësi të shkallës së shkeljes, me:

gjobë deri në 500 lekë;

pezullim të veprimtarisë deri në 60 ditë;

c) sekuestrim të mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe të materialit inert gjendje, të grumbulluar e të fraksionuar.

Policia e Ndërtimit ka të drejtë t’i propozojë sipas rastit organit kompetent heqjen e licencës profesionale dhe të lejes së veprimtarisë përkatëse të shoqërive që shkelin dispozitat e mësipërme.

Kundër vendimit të Kryetarit të Degës së Policisë së Ndërtimit në rreth bëhet ankim te Drejtori i Policisë së Ndërtimit brenda 5 ditëve nga data e komunikimit të vendimit.

Neni 62

Për shkeljet e parashikuara në nenin 17, shkronjat a, b, c dhe d kundërvajtësi dënohet me gjobë deri 100 000 lekë.

Neni 63

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8605, datë 20.4.2000)

Neni 64

Për shkelje të nenit 22 kundërvajtësit dënohen me gjobë deri në 100 000 lekë me pezullim veprimtarie deri në rinovimin e kushteve të lejes ose autorizimit. Për rastin e koncesioneve veprohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

Neni 65

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8605, datë 20.4.2000)

Neni 66

Për shkelje të parashikuara në nenet 27, pika 1, dhe 28, pika 5, kundërvajtësi dënohet me gjobë deri në 500 000 lekë.

Neni 67

Për shkelje të nenit 40, pika 2, paragrafët a, b dhe c, kundërvajtësit dënohen me gjobë deri në 100 000 lekë dhe, kur formon vepër penale, jepet për ndjekje penale.

Neni 68
(Shfuqizuar me ligjin nr. 8605, datë 20.4.2000)

Neni 69
(Ndryshuar me ligjin nr. 8605, datë 20.4.2000)

Kundër vendimit të autoritetit të ujit, si dhe kundër vendimit të Drejtorit të Policisë së Ndërtimit mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Vendimi i autoritetit të ujit ose i organit të Policisë së Ndërtimit, që nuk ankimohet nga kundërvajtësi, quhet titull ekzekutiv.

Padia në gjykatë kundër vendimit të autoritetit të ujit ose të Drejtorit të Policisë së Ndërtimit, nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Kur gjykata vendos pranimin e padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar nga organi që ka dhënë vendimin.

Në rastet e përsëritjeve të kundërvajtjeve administrative, kur nuk bëhet ankim kundër vendimit të autoritetit të ujit ose atij të organeve të Policisë së Ndërtimit, si dhe kur gjykata rrëzon padinë e paraqitur kundër tyre, konfiskohen mjetet, pajisjet e punës dhe materiali inert gjendje i grumbulluar dhe i fraksionuar.

Gjoha, si dhe shpenzimet që përballohen nga autoriteti i ujit dhe nga organet e Policisë së Ndërtimit paguhen nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të tyre ose nga data kur ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës.

Përveç rasteve të parashikuara nga paragrafi i gjashtë i këtij neni, masa e sekuestrimit, e vënë mbi këto mjete dhe materiale, hiqet vetëm pasi të jenë shlyer gjocat dhe shpenzimet e përballuara nga autoriteti i ujit dhe nga organet e Policisë së Ndërtimit.

Kundërvajtësi, për çdo ditë vonesë paguan kamatë në masën 2 për qind në ditë, deri në 1 muaj. Gjocat dhe vlera e shpenzimeve të përballuara nga autoriteti i ujit dhe nga Policia e Ndërtimit paguhen pranë organit që ka vendosur gjobën.

Neni 70 **Rregullimi i veprimtarive të kryera para hyrjes në fuqi të ligjit**

Personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtari mbi rezervat ujore, ose shfrytëzojnë materiale inerte në përputhje me nenin 20, në bazë të një lejeje ose autorizimi të marrë, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të vazhdojnë të kryejnë veprimtarinë e parashikuar me leje ose autorizim, duke i rinovuar këto brenda 60 ditëve nga data e krijimit të këshillave dhe baseneve.

Neni 71

Kur leja ose autorizimi administrativ i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ato anulohen, por pa i hequr të drejtën mbajtësit të kërkojë një leje të re ose autorizim të ri.

Neni 72

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 73

Në ligjin mineralar shqiptar nr.7796, datë 17.2.1994, neni 3 dhe neni 75, hiqen fjalët “rërën, zhavorrin” dhe në grupin e katërt të tabelës “A” të grupit të mineraleve hiqen fjalët “rërat, zhavorret dhe zhuret”.

Në ligjin nr.7846, datë 21.7.1994 “Për ndërtimin, administrimin, mirëmbajtjen e sistemeve ujëse dhe kulluese”, në nenin 8 hiqet paragrafi i dytë.

Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 74

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 1469, datë 18.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**